



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 133 prot.

Tiranë, më 04 . 09 . 2024

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 4 datë 04.09 2024

*Për*

*miratimin e sigurimit të pjesshëm të 480 teksteve mësimore/shkollore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në SHBA, Kanada, Australi dhe Japoni për vitin shkollor 2024-2025*

Në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, vendimit nr. 469, datë 26.07.2018, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 443, datë 26.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”, shkresës së ardhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit “Kthim përgjigje”, nr. 3324/1 prot., datë 18.06.2024, protokolluar pranë Qendrës së Botimeve të Diasporës me nr.80/1, datë 21.06.2024, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën,

V E N D O S I:

1. Miratimin e sigurimit të pjesshëm të 480 teksteve mësimore/shkollore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë për vitin shkollor 2024-2025, përkatësisht në: SHBA 350 tekste (Niveli I), Kanada 55 tekste (Niveli II), Australi 65 tekste (Niveli I) dhe Japoni 10 tekste (Niveli I), bazuar në kërkesat e misioneve diplomatike të Republikës së Shqipërisë në këto shtete, të dërguar zyrtarisht në Qendrën e Botimeve të Diasporës (QBD) me shkresën nr. 7781 prot., datë 17.05.2024 nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe në shkresën nr. 3324/1 prot., datë 18.06.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ku përcaktohet se përgatitja e teksteve shkollore për diasporën duhet të bëhet me fonde buxhetore të miratuara për QBD për vitin 2024, në bazë dhe për zbatim të legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën**

**VOLTISA BLETA (KOÇI)**

**Anëtarë:**

**Znj. Anila Ferizaj**

**Znj. Enkeleda Riza**

**Znj. Evalda Paci**

**Znj. Brunilda Spahiu**